



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8969 Prot.

Roskovec, më 30, 05 2024

VENDIM

NR 31 .DATË 29 .05 .2024

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUJIN PRILL 2024”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 26.04.2024, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, mbledhje jashtë radhe, për muajin Prill 2024.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3107/1 Prot.

Roskovec, më 26.04.2024

Procesverbal Nr.5

-I mbajtur sot, datë 26.04.2024, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje jashtë radhe, e thirrur me kërkesë të 1/3 së anëtarëve të Këshillit, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
3. Për miratimin e dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec me procedurë të thjeshtuar.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰⁰

Këshilltarët prezent: E.Musko, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, Zh.Metushi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, J.Begaj, P.Toro, A.Hoxha, V.Çepele, A.Pelo, S.Bibo Qamili, F.Feleqi.

Këshilltarët që mungojnë: Elisabeta Toska, Kryetari Afrim Plaka pasi ka deklaruar konfliktin e interesit për pikën Nr.3, në mbledhjen më parë.

Prezent nga bashkia: Kryetarja e Bashkisë znj.M.Bufi, Nënkyetari M.Goga, Dr.Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit E.Hoxha, grupi i punës së dokumentit të PPV-së.

Me plotësimin e kuorumit, Nënkyetarja Ermira Buzi hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 19 këshilltar. Kjo mbledhje po drejtohet nga Nënkyetarja E.Buzi, pasi Kryetari i Këshillit ka deklaruar konfliktin e interesit për pikën 3 të rendit të ditës që në mbledhjen e mëparshme. Ermira-para se të hedhim në votë rendin e ditës, do ju lutesha qytetarëve të pranishëm sot, kanë të drejtë të dëgjojnë, por në bazë të rregullores nuk duhet të flasin që të mos pengojnë në vazhdimin e punës së mbledhjes së këshillit. Fredi- për procedurë, kërkojmë që mbledhja e këshillit të pasqyrohet në media, përderisa ka gazetar jashtë, nuk ka asgjë të keqe. Ermira-kjo që thatë ju është procedura? A nuk po e japim ne transmetimin online të kësaj mbledhje? Fredi-ça të keqe ka nëse vijnë dhe media? Ne miratim mbledhjen e kaluar programin e transparencës, ne si këshill e votuam dhe e pranuar. Ermira-zhvillimin e mbledhjeve online e kemi vendosur në bazë të ligjit

dhe rregullores,dhe atë jemi duke bërë. Dhurata-e keni vendosur në bazë të ligjit se e përmban ligji. Fredi-ka ndonjë gjë jashtë ligjit të vijtë gazetarët këtu?U bëj thirrje qytetarëve të ruajnë qetësinë,mos ta kthejmë politike,kjo mbledhje nuk është politike dhe mos ta politizoj asnjëri.Për procedurë cila është arsyeja znj.Nënkryetare që është thirrur mbledhja sot?Se sipas ligjit të pushtetit vendor dhe rregullores së këshillit,mbledhja e Këshillit Bashkiak bëhet 1 herë në muaj,jo 1 herë në javë. 2.Në mbledhjen e kaluar kemi kërkuar që kjo pikë e rendit të ditës të lihet për mbledhjen tjetër,sepse njoftimet sipas ligjit janë bërë,por janë bërë me imeil,me facebook dhe internet.Për vet faktin se bashkia jonë ndodhet në 14 fshatra,jemi shumë të vetdijshëm të gjithë ne këtu,se njerzit në përgjithësi nuk kanë imeil as facebook.Unë e di që sipas ligjit ju e keni bërë transparencën,por fakti qëndron që në konsultimet publike dhe në salla ka pasur vetëm punonjës bashkie,ose familjar të tyre,me përjashtim të qytetarëve që preken nga ky projekt. 3.Kush janë 1/3 e këshilltarëve që e kanë kërkuar këtë mbledhje? 4.A nuk duket znj.Nënkryetare që po përdoret kaq me ngut kjo mbledhje për interesa të privatëve,të firmës,sepse kjo nuk është as një fatkeqësi natyrore që e ka thirrur Kryetarja për një mbledhje jashtë radhe,as gjendje e jashtëzakonshme.A ju duket ju që po përdoret Këshilli Bashkiak për interes të privatit,dhe jo për interesat e atyre që na kanë zgjedhur dhe po presin jashtë? Sekretarja sqaron se në bazë të ligjit 139 këshilli bën jo më pak se 1 mbledhje në muaj,por mund të bëj edhe më shumë.Lexon shkresën me emrat e 1/3 së këshilltarëve që e kanë thirrur këtë mbledhje.Mbledhja e sotme është shumë e ligjshme.

1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Hidhet në votim rendi i ditës dhe miratohet me 11 vota pro,dhe 8 vota kundër nga koalicioni Bashkë Fitojmë.

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Dhurata-unë nuk isha mbledhjen e kaluar për arsye shëndetsore,dhe do i kërkoja sekretares nëse mundet ta bëj me kompjuter sepse shkrimi ishte i pakuptueshëm. Sekretarja-po,dhe në rast se ke ndonjë gjë mund ta sqarojmë sot këtu se e kemi procesverbalin origjinal prezent. Hidhet në votim dhe miratohet me 18 vota pro,1 kundër Dh.Malka.

3.Për miratimin e dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec me procedurë të thjeshtuar.

Ermira-në pyetjet që ishin rreth materjalit të paraqitur nga drejtorja përkatëse,i keni të gjithë jeni njohur me të.Pyetjet besoj se u ezauruan mbledhjen e kaluar,dhe përgjigjet i morët nga drejtorja përkatëse,dhe sot nëse ka ndonjeri ndonjë pyetje apo diçka të paqartë,do ju jap fjalën për diskutime.Do ju lutesha të respektojmë njeri-tjetrin dhe të vazhdojmë me radhë. Dhurata-unë kërkoj që drejtoresha të na sqarojë edhe një herë për publikun dhe për ne këshilltarët, sepse unë nuk isha mbledhjen e kaluar.Unë materjalin e kam lexuar,por edhe një sqarim nëse është e mundur. Ermira-ne pothuajse pjesa më e madhe ishim prezent mbledhjen e kaluar,dhe e pamë dokumentin të paraqitur,do kërkoj edhe një miratim nga këshilltarët nëse janë dakort që të paraqitet për sqarim edhe një herë nga e para materjali.Hidhet në votim propozimi 9 vota pro nga koalicioni BF dhe

Zh.Metushi, 10 vota kundër nga PS.Propozimi nuk miratohet. Ermira-kalojmë tek diskutimet,kush e do fjalën?Nëse ka ndonjë pyetje që do të mari një përgjigje shteruese,ose ndonjë pyetje ndryshe nga ato që u zhvilluan mbledhjen e parë,do ta merrni fjalën në bazë të rregullores,bëjini pyetjet të grupuara. Pegiola- të bëhet njëherë pjesa që materjali të jetë prezent,pse duhet ta nxitojmë mbledhjen,sepse qytetarët kanë ardhur të dëgjojnë fakte. Dhurata-unë do kaloj direkt me diskutime,është e drejta ime,sepse ju nuk u përgjigjët. Ermira-tham do bëjmë pyetjet,përgjigjet,pastaj diskutimet,pse je e nxituar? Dhurata-jo,të nxituar jeni ju,se nuk ju premtan koha,të paktën për respekt të atyre qytetarëve që janë aty. Ermira-për respekt të qytetarëve ne i kemi zbatuar çdo gjë korrekt me ligjin.Mbledhjet e këshillit kanë qënë të hapura,qytetarët mund të kishin marr pjesë edhe në mbledhjen e herës së kaluar,dera ka qënë e hapur,janë bërë dëgjesat.Ju mund ti beni pyetjet e qytetarëve.Nuk ka pyetje.Ermira-ju lutem ti keni pak të përmbledhura diskutimet. Dhurata-unë jam Kryetare e Grupit dhe kam të drejtën ligjore. Fredi-ju po e merrni sikur aty jashtë po bëhet luftë,dhe po e beni mbledhjen për 3 minuta,nuk më duket as etike,as morale,as ligjore.Ne e kemi kohën në dispozicion,ca problemi ka? Dhurata-e nderuar Kryetare e Bashkisë znj.Majlinda Bufi,e nderuar Nënkryetare e Këshillit znj.Ermira Buzi,sot jemi thirrur jashtë radhe për të diskutuar dhe miratuar dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec me procedurë të thjeshtuar,i cili është hartuar vite më përpara.Së pari në emër të komunitetit ku mua më besuan votën si antare e Këshillit Bashkiak,dua tju kujtoj se ne kemi bërë një betim në këtë sallë,citon formulën e betimit.Ky është betimi që kemi bërë të gjithë ne këtu.Vallë a ma lejon ndërgjegjja mua miratimin për ndërtimin e një Teci 800 m larg njerzve dhe kafshëve të zonës time?Jo të nderuar kolegë këshilltar,nuk ma lejon kurrë.Shpreh habi sesi drejtuesit e bashkisë tonë në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë kanë shpenzuar miliona euro për ndërtimin e pikave të grumbullimit,për tu ardhur në ndihmë fermerëve(gjoja).Si mund ti hedhin poshtë gjithë këto para?Si mund të kërkojnë ndërtimin e një Teci,i cili ka afekte negative në klimë,në burimet ujore,ndikimin vizual dhe atë akustik?Kështu e mbroni ju mirqënien e popullit tuaj?Çfarë borxhi ju kanë 9984 familje të bashkisë tonë që ju do i rrethoni me ndotjen e ajrit,dioksidin e squfurit,dioksidin e azotit dhe dioksidin e karbonit?Pse znj.Kryetare nuk na mbështet dhe mbron ne qytetarët e saj?Unë do i sugjeroja Kryetares të ndiqte shembullin e Kryetarit të bashkisë Korçë në 2017,i cili i mbështeti fuqishëm banorët e vet së bashku me Prefektin e Qarkut Korçë ,duke mos e lejuar po këtë kompani për ndërtimin e Tecit.Në emër të qytetarëve të bashkisë tonë e nderuar Kryetare,të bëj thirrje të stoposh zbatimin e këtij projekti,konsultohu me ambientalist të mirfilltë,duaji bashkëqytetarët e tu,puno dhe jeto për ta. Fredi-do kërkoj në emër të gjithë këshillit,sepse këtu ka ardhur një ambientalist Prof.Dr.Sazan Guri,sepse ne nuk kemi informacione,nuk jemi specialist të fushës.Ne na ka nderuar z.Sazan Guri me ardhjen e tij,dhe të na e shpjegoj ai projektin,ai nuk është as politik.Kërkoj tja japim fjalën,të marrim më shumë informacion për mua,këshilltarët,por edhe për popullin në sallë dhe jashtë. Kryetarja-e para dua tju a bëj të ditur të gjithëve që mbledhjet janë të ligjshme,ashtu si e shpjegoj dhe sekretarja,procedura është e ligjshme,është njoftuar korrekt sipas ligjit,mbledhjet janë të hapura,kanë qënë gjithmonë të tilla,dhe kjo sot është e hapur,dhe ka të drejtën të dëgjojë çdo qytetar.Këtu dëgjohen qoftë ata që duan të bëjnë një aksion politik,të abuzojnë me fjalën,dhe ne që po përpiqemi të zbatojmë ligjin.E dyta nuk ka asnjë shkelje,po të kishte shkelje ju do e kishit rezervuar dhe do e kishit kapur të drejtën tuaj,jam shumë e bindur për këtë.Ajo që është më e rëndësishme në lidhje me këtë projektvendim,ne si institucion kemi zbatuar gjithë hapat ligjor.Këtu sot nuk po miratojmë dhe nuk po kërkojmë votën tuaj për të marr një vendim për zbatim Teci.Sot

ju kemi kërkuar të ndryshojmë PPV-në në 6 njësi strukturore,të cilat i hapin rrugë inisiativave të bizneseve vendas dhe jo vendas.Ajo çfarë po kërkojmë sot dhe për çfarë dëgjesat janë bërë,ka lidhje vetëm me ndryshimin e njësisve strukturore të PPV-së,dhe jo me ndërtim Tecit.Kjo duhet të jetë e qartë për të gjithë qytetarët e Roskovecit.Ministria e ka miratuar PPV konform ligjit,dhe gjatë zbatimit ne na kanë dal të nevojshme disa ndryshime në njësi strukturore të caktuara,inisiativën për këtë gjë e kemi filluar herët.Nëse vullneti juaj do ta miratojë këtë gjë,ajo që ndodh është që kësaj njësie strukturore ku deri më tani zhvillohet aktivitet bujqësor,i hapet rruga edhe për aktivitet ndryshe nga ai bujqësor,dhe nëse në këtë njësi strukturore do të ketë ose jo aktivitet industrial,qoftë edhe ky që ju përmendni,nuk e miratojmë ne sot,e miratojnë institucionet përkatëse,pasi të kenë shqyrtuar gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ligji në lidhje me ndotjen,efektet mjedisore,teknologjinë dhe gjithçka.Me të drejtë qytetarët kërkojnë shpjegim,por jo sot,se nuk është ky momenti.Unë e para me qytetarët e mi,do kërkoj nga gjithë ekspertët,nëse ky aktivitet i cili sot ka shprehur interes,do të vihet në zbatim,çfarë sjell për Roskovecin,është e një teknologjie të duhur apo jo,a i përmbush parametrat mjedisor apo jo?Do e kërkoj unë e para,ashtu siç ua premtova dje qytetarëve në Suk 1,kam vajtur me dëshirën time thjesht për ti qartësuar,dhe po ua them prapë publikisht,sot nuk është momenti të jepet kjo gjë.Sot ne miratojmë ndryshimin e njësisve strukturore,do ti vlej atyre që kanë inisiativë në biznes.Është në të mirën e qytetarëve që nuk marrin dot lejen e shfrytëzimit.Më vjen keq që ju keni ngritur ekspertin për ta sjellë sot këtu,se nuk është sot momenti,do ta kërkoj unë atë në momentin që duhet.Nuk ka fare ngjashmëri rasti i Korçës me këtë të sotmin sepse atëherë nuk ekzistonte fare Tapi. Fredi-nuk na ke sjellë asnjë projekt të miratuar nga qeveria. Kryetarja-ju kam sjellë projekt-vendim për miratim të njësisve strukturore në PPV,kemi zbatuar ligjin me dëgjesa publike dhe me gjithçka tjetër të nevojshme,me grupe pune,me ekspert që kanë hartuar gjithë dokumentat teknik në përputhje me atë që kërkon ligji.Unë ju kërkoj sot gjithë këshilltarëve,sot ju miratoni ndryshimet në PPV dhe asgjë tjetër. Dhurata-pse nuk i solli znj.Kryetare ekspertët po kujtohet sot dhe dje,se mesa shoh ju jeni e pa informuar vet. Kryetarja-nëse kjo shprehje interesi do të zhvillohet dhe do të marri miratimet përkatëse,padyshim që ne kemi të drejtën të kërkojmë çdo lloj informacioni. Dhurata-ne nuk duam informacion,por duam stopimin e këtij projekti,nuk kemi interes për bërjen e Tecit. Emels-siç e tha dhe Kryetarja që nuk është eksperte e fushës,ne do kishim dëshirën që ta dëgjojmë atë zotrin që është specialist i fushës,meqë ky gazi na shkoka në Gjermani,Austri.Të na jepte informacion më të detajuar sesi funksionon kjo gjë,dhe ne pse mos ta votojmë,kur kjo qënka kaq mirë për komunitetin. Ermira-do të flasi por pasi të ketë mbaruar procesi i mbledhjes. Fredi-më vjen shumë keq znj.Nënkryetare që ju po bëni ça thotë Kryetarja e Bashkisë,ky është institucion i pavarur.Nëse keni qëllimin e mirë për respekt tonin dhe të institucionit,ta marri zotria fjalën për respekt. Emels-ta hedhim në votim, në rast se kolegët janë dakort ta dëgjojmë atë zotrin. Elmazi-me gjithë respektin që kemi për ata që janë mbrapa,unë kërkoj si Kryetar i Grupit të zbatosh rregulloren. Viola-e dëgjova fjalimin e Kryetares,dua ti bëj një pyetje.Sa siguri do kemi ne,që në qoftë se këto vendime do i kalojnë etapat,dhe vjen momenti që na shfaq anët më negative të mundshme si projekt. Kryetarja-jemi në momentin kur po i hapim rrugë ndryshimeve në PPV,nuk jemi në momentin kur po i hapim rrugë kësaj inisiativë.Nëse kjo gjë do të vazhdojë,ne do jemi të gjithë bashkë,unë e para,do ti kërkojmë Ministrive të na japin gjithë informacionin e duhur. Dhurata-pse i bëni të gjitha pikat bashkë,se jo të gjitha pikat janë në shërbim të qytetarëve. Kryetarja-PPV është dokument strategjik,që ndryshon në një periudhë të caktuar,dhe do argumenta bindëse,prandaj janë bërë të gjitha bashkë.Në momentin që kjo gjë do mari rrugë,do jemi ne të parët,unë bashkë me ju

që do kërkojmë informacionet e duhura. Dhurata-jo Kryetare nuk ta zëm besën,e more përgjigjen nga populli mbrëmë,ça konkluzioni nxorët dje? Kryetarja-e dashur këshilltare,juve keni qënë prezent kur është bërë dëgjesa publike,dhe jo vetëm që keni qënë dakort ,por keni kërkuar dhe me të drejtë se cilat janë përfitimet nëse kjo ndodh. Dhurata-për çfarë kam qen dakort,ja ku i kam shënimet,të lutem Kryetare mos u merr me thashetheme se stë kanë hije.Ai Tec nuk është përfitim,por është vetvrasje,do vriten fëmijet tanë. Kryetarja-ne duhet të jemi bashkë si ti shtojmë përfitimet e zonës. Amarildo-ne nuk jemi asnjëherë kundër qytetarëve dhe as biznesit,ne jemi të gjithë pro të votojmë,por duke hequr këtë pikë.Mos ti hapim rrugën një të keqe të madhe,një bombe me sahat.Zona më e ndotur sot në Republikën e Shqipërisë është Patos-Marinza,unë kam punuar 5 vjet tek Bankers Petroleum,dhe ju them me bindje që është një nga zonat më të ndotura.Problemi që kanë banorët që jetojnë atje janë karboni i lartë në gjak,anemia.Pse duhet ti hapim rrugën kësaj të keqe të madhe,kur ne mund ta ndalojmë që këtu,se ajo zonë është hambari i Myzeqesë.Këta banor që janë këtu dhe ata jashtë i kanë ngritur me mund dhe djersë ato sera,ne duhet ti hapim rrugë një ndërtimi që nuk i shërben banorëve,por një numri të caktuar biznesmenësh,se ajo energji që do prodhohet atje nuk është për banorët,ndaj do ju lutesha shumë,skemi asgjë politike,pasi këtu bëhet fjalë për jetën e njerëzve.Kam një thirrje të sinqertë,ti kalojmë të gjitha,por jo këtë,mos e lejoni se do jetë bomba e dytë.Mos ta kthejmë në Marinëz të dytë,ti lëm këta banor në punën e tyre,jetën e tyre,të trashëgojnë atë që u kanë lënë të parët e tyre,në shtëpitë e tyre. Pegiola-siç e dim mastrimet tuaja kanë kohë që ndodhin,dhe kur ka ardhur ky projekt në bashki, juve nuk keni kërkuar dhe nuk jeni bërë palë me qytetarët,pse dolët ju sot dhe bëni thirrje që unë do jem bashkë me ju? Emels-si e priten qytetarët,a janë dakort ata për ndërtimin e Tecit?Duke pasur parasysh të gjithë ishat që na kanë drejtuar,që e kanë braktisur Roskovecin,ti do vazhdosh të jetosh këtu edhe pas ndërtimit të Tecit? Kryetarja-nuk ka lidhje me çështjen. Dhurata-a mund të hiqni pikën e parë,dhe të miratojmë pikat e tjera? Nënkryetarja-është 1 dokument.Dua të them mendimin tim,unë jam bijë nga Marinza,unë do ta votojë pro këtë vendim dhe e kam bindje,sepse unë besoj në zhvillimin e vendit tonë. Fredi-ju znj.Kryetare nuk jeni e sinqertë me ne dhe banorët,e përdorni për momentin për të marr ca vota por nuk është ky qëllimi.Ju nuk e latë ekspertin e bashkisë të citonte planin,e cila herën e parë na tha që ky Tec do plotësojë 10% e nevojave të gjithë Shqipërisë,konsumin vjetor do e plotësojë ky Tec,dhe nëse nuk e ka thënë kështu,unë bëj dorëheqjen si këshilltar.Ju keni sjellë këtu Tecin,sipërfaqen e Tecit,katet e ndërtesës,dhe nuk qenka ky momenti?Ky është momenti znj.Kryetare që të jesh me qytetarët ose kundër tyre.E nderuar znj.Nënkryetare dhe këshilltar,mendoj se të gjithë i kuptoni dëmet që shkakton ndërtimi i Tecit në zonën ku ne po jetojmë,por dhe për ju që se kuptoni,po ua tregoj me dy fjalë, duke marr shkas nga një situatë imja personale.Para pak kohësh kam patur probleme shëndetësore në mushkri,kam bërë vizita me specialist brenda dhe jashtë vendit,dhe pyetja e të gjithë doktorëve ishte :A e pini cigaren dhe a keni fabrika dhe uzina afër?Kur unë u thoja të kundërtën,që jetoj në fshat 500 m mbi nivelin e detit,e përjashtonin kategorikisht sëmundjen e kancerit dhe ashtu ndodhi.Ky Tec do jetë më shumë sesa një uzinë dhe fabrikë,ndaj të gjithë sot ti lëm mënjane bindjet politike,për të mirën tonë dhe komunitetit.Duhet të tregojmë sa dinjitet kemi ose sa lehtë shitemi,aty ku bëhet fjalë për shëndetin tonë,jetën tonë,për fëmijët tanë. Kryetarja-askush nuk mund të abuzojë me fjalën,projekt-vendimi ka të bëjë vetëm me ndryshimin e njërive strukturore. Amarildo-ky investim nuk përbën përfitim për komunitetin,pasi ata janë të vetpunësuar,përveç se do ju sjelli sëmundje dhe ndotje,por garantojë që ajo zonë pasi të ndërtohet Teci,do jetë zonë e braktisur. Viola-pse duhet të bëhemi ne sot vendimmarrës për të ardhmen,që

dhe ata banorë që kanë vendosur të jetojnë aty,të largohen.Elmazi-jep shembullin e Italisë në përdorimin e gazit.Ne kërkojmë të vëmë një barrikadë pa u bërë fare,u ftoj të gjithëve ta votojmë dhe ti hapim rrugë kësaj pune. Emels-para se ta kalosh në votim,na jep mundësinë të dëgjojmë ekspertin e fushës. Ermira-besoj i kemi ezauruar të gjitha.Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 11 vota pro,8 vota kundër nga koalicioni Bashkë Fitojmë (BF). Dhurata-shumë faleminderit,mbajeni mënd do shkruheni gjatë në histori.Sazan Guri-sqaron mbi projektin.Nëse tek Plani i Përgjithshëm Urban është rasti i parë që ndërhyet tek boniteti 2,si rasti i Butrintit,po qe se ne do pranojmë një ndërhyrje në PP urban në cilësinë e tokës,ju kaq keni në dorë deri tek kjo,ndërroni ADN-në e tokës,kaq do ju pyesin, si në rastin e Vlorës.Kryetarja-nuk jemi në rastin e Vlorës,jemi në rastin e gazit.Sazan Guri-është cikël i kombinuar naftë-gaz.Qeveria shqiptare nuk ka marrëveshje me Tapin.Teci më i mirë me gaz në Rusi,e ka rrezen 5-6 km pa 1 banor,mbi 6 km bëni ça të doni.Nënkryetarja mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

**NË MUNGESË DHE ME POROSI
ZËVENDËSKRYETAR**

Ermira Buzi

